



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 4.2.2025

Nr: 62

Ora: 10:00

VENDIM

PËR

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV TË VEPRIMTARIVE PUBLIKE TË BASHKISË
CËRRIK, PËR PERIUdhËN 19 JANAR – 25 JANAR 2025**

Sot, më datë 4.2.2025 unë, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mora në shqyrtim çështjen administrative me:

SUBJEKT: Bashkia Cërrik

OBJEKT: Shqyrtimi administrativ i veprimtarive publike të Bashkisë Cërrik, për periudhën 19 janar deri më 25 janar 2025.

BAZA LIGJORE: Nenet 19 pika 1, shkronja “n”, 92, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, si dhe vendimi nr. 9, datë 24.12.2020, i Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar.

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

KONSTATOJ:

Gjatë periudhës 19-25 janar 2025, Bashkia Cërrik ka raportuar në ndërfaqen e raportimeve 1 (një) veprimtari, në respektim të afatit ligjor, por referuar tematikës përbën veprimtari të ndaluar, sipas parashikimeve të vendimit nr. 9/2020, të Komisionit Rregullator, i ndryshuar, si më poshtë vijon:

Data: 4.2.2025 Nr: 62
Ora: 10:00



“Për shqyrtimin administrativ të veprimtarive publike të Bashkisë Cërrik për periudhën 19 janar – 25 janar 2025”

➤ Në datën 23.1.2025, Bashkia Cërrik ka raportuar për të zhvilluar një veprimtari në datën 28.1.2025, ora 10.00, në njësinë Administrative Cërrik, me tematikë “Tryezë diskutimesh”, “Kryetari i Bashkisë Cërrik do të zhvillojë një takim me strukturat e Partisë Socialiste në qytet, ku do të diskutohen çështje të rëndësishme që lidhen me proceset zgjedhore. Në qendër të diskutimeve do të jenë strategjitë për përgatitjen e zgjedhjeve të ardhshme. Një tjetër pikë kyçe e takimit do të jetë vota e diasporës, një element që konsiderohet thelbësor për përfshirjen e plotë të qytetarëve shqiptarë që jetojnë jashtë vendit në procesin demokratik të vendit.

Nëpërmjet postës elektronike, administrata e KQZ-së i ka kërkuar informacion sqarues Bashkisë Cërrik në lidhje me shkaqet dhe rrethanat e kryerjes së shkeljes.

Personi përgjegjës për raportimin për Bashkinë Cërrik ka dërguar pretendimet nëpërmjet postës elektronike, duke sqaruar se: “Aktiviteti nuk është zhvilluar dhe nuk është publikuar në asnjë rrjet social”.

Vlerësohet se veprimtaria e raportuar është e natyrës politike/elektorale dhe nuk është veprimtari publike në kuptim të nenit 92, të Kodit Zgjedhor, dhe si e tillë nuk mbart detyrim për raportim në KQZ.

Pas kryerjes së hetimit administrativ rezultoi se, pasi veprimtaria e raportuar ka marrë statusin si “E Ndaluar”, nga KQZ në ndërfaqen e raportimeve, për shkak të tematikës, Bashkia Cërrik nuk e ka zhvilluar aktivitetin.

Në përfundim të shqyrtimit, tërheq vëmendjen Bashkisë Cërrik që në vijim të tregojë kujdes të shtuar mbi vlerësimin e duhur të veprimtarive, të cilat parashikohen nga legjislacioni në fuqi për t’u raportuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pika 1, shkronja “n”, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator “Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, agjencive, enteve shtetërore, kategoritë e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”, i ndryshuar,

V E N D O S:

1. Pushimin e hetimit administrativ ndaj Bashkisë Cërrik.
2. Ky vendim do të njoftohet nëpërmjet postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI